

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

12.05.2023
Ora 12:57

RENDI I DITËS

Shorti “Për caktimin e relatorëve për kërkesat ankimore nr. 28, 29, 30 dhe 31”.

PJESËMARRJA :

- Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema

Z. Y. Merkaj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Sot në datën 12.05.2023 ora 12:57, zhvillohet procedura për caktimin e relatorit, për kërkesat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosje sanksioni administrativ me numër 28,29,30 dhe 31. Procedur e shortit është parashikuar në nenin 14 të Rregullores së KAS-it vendimi 35, për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre ku janë vendosur kërkesat e Komisionerit 28, 29, 30 dhe 31, shiriti i fundit është i bardhë dhe pa shënime. Shiritat palosen dhe futen në gogla, me peshë dhe ngjyrë të njëjtë, në një enë transparente. Anëtarët e KAS-it, kanë dhënë autorizimin që të tërhiqen goglat në emër dhe për llogari të tyre nga përfaqësues i administratës të KQZ-së, të 5 goglat futen në një enë transparente, dhe vazhdojmë me rendin alfabetik rritës. Duke filluar nga zoti Ervin Lako.

-Tërhiqet gogla -Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Ervin Lako: - kërkesë e Komisionerit numër 30.

-Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Elvis Çefa: - kërkesa e Komisionerit numër 28.

-Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Ilirjan Rusmali: - kërkesa ankimore numër 29.

-Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*


Z. Koli Bele: - kërkesa e Komisionerit numër 31.

Në fund, në emër dhe për llogari të:

Z. Ledio Braho: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit kërkesa ankimore numër 28 ka relator zotin Elvis Çefa, kërkesa ankimore numër 29 ka relator zotin Ilirjan Rusmali, kërkesa e Komisionerit numër 30 ka relator zotin Ervin Lako dhe kërkesa numër 31 e Komisionerit ka relator zotin Koli Bele, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.05.2023*

12.05.2023
Ora 12:59

RENDI I DITËS

“Shqyrtimi paraprak i kërkesës nr. 27, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt “Vendosje të sanksioneve administrative””.

PJESËMARRJA:

- **KAS-i:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Ledio Braho.
- **Stafi i KQZ-së:** Z. Ylli Merkaj, Z. E. Mema.
- **Të tjerë:**

Z. E. Lako: Atëherë çelim seancën e KAS-it për shqyrtimin paraprak të kërkesës me nr. 27, të dorëzuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, drejtuar KAS-it, me objekt: kërkesë “Për vendosje sanksioni administrativ ndaj zotit Gledian Llatja kryetar i Bashkisë së Elbasanit, gjobë në masën 10 000 lekë dhe kërkesë “Për vendosje sanksioni administrativ ndaj zotit, zotit Arif Tafani, kryetar i Bashkisë së Belshit, gjobë në masën 10 000 lekë. Të pranishëm në seancë janë anëtarët e KAS-it, Sekretari i Përgjithshëm dhe administrata e KQZ-së. Kemi palë të interesuara? Jo! Njoftimet janë bërë, apo jo?!

Z. Y. Merkaj: Njoftimet janë bërë, nuk ka!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.05.2023**

Z. E. Lako: Mirë vazhdojmë seancën për plotësimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes. Shkurtimeisht, cili është mendimi dhe opinioni juaj për plotësimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes, zoti Merkaj?

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë administruar indicie për organizimin e nëntë veprimtarive nga shtatë institucione publike, për të cilat rezultoi se janë kryer në kundërshtim me përcaktimet e neneve 91, 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Duke qenë se provat e marra dhe pasi i shqyrtoi paraprakisht, Komisioneri ka vlerësuar se informacionet e dhëna krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ. Nisi hetimi administrativ dhe me vendimin nr. 480, datë 10 maj 2023 ka marrë në shqyrtim denoncimet me numër 210 ID, 237, 238, 239, 240, 241, 242, 280, 281 të KRIIK-ut dhe të deputetit Flamur Noka. Në përfundim të procesit administrativ, duke qenë se rasti objekt denoncimi, gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se nëpërmjet vënies në dispozicion dhe thirrjeve elektorale që përbëjnë shkelje të detyrimeve të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ka vendosur t'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masave administrative në vlerën 10 000 lekë për kryetarin e Bashkisë Elbasan dhe kryetarin e Bashkisë Belsh. Nga verifikimi paraprak i kërkesës së Komisionerit, konstatohet se i plotëson të tre elementët e parashikuar në nenin 130 të Kodit Zgjedhor dhe për këtë arsye kërkojmë kalimin e çështjes në seancë publike. Faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Merkaj! Nga anëtarët e KAS-it ka ndonjë pyetje? S'ka! Mirë, mendoni që ta kalojmë? Dakord!

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.05.2023*

Atëherë, KAS-i i konsultuar në vend, vendosi:

Kalimin e kësaj çështje për shqyrtim dhe caktimin e seancës së themelit sot në përfundim të kërkesës me numër 26, pra rreth orës 14:30. Kjo për të bërë njoftimet nëse.. faleminderit!

Vendimi nr. 101

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

12.05.2023
Ora 13.05

RENDI I DITËS

**Shqyrtimi i kërkesës nr. 25 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt
“Vendosje të sanksioneve administrative”**

PJESËMARRJA:

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. L. Braho: Mirëdita! Çelim seancën e shqyrtimit administrativ të kërkesës së Komisionerit nr. 25 të datës 10.05.2023. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i është drejtuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve me kërkesë me objekt vendosjen e sanksionit administrativ ndaj tre kryetarëve të bashkive, respektivisht zotit Gledjan Llatja, kryetar i Bashkisë Elbasan; zotit Andis Salla, kryetar i Bashkisë Cërrik dhe zotit Rakip Suli, kryetar i Bashkisë Kamëz. KAS-i, pasi ka zhvilluar seancën e shqyrtimit të elementeve të formës dhe të përmbajtjes, ka vendosur që ta kalojë për shqyrtim këtë kërkesë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Relator i saj jam unë, anëtari Ledio Braho. E pranishme është trupa e plotë e KAS-it, e përbërë nga pesë anëtarë. E pranishme është administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga sekretari i Përgjithshëm, zoti Ylli Merkaj. Nuk ka të pranishëm nga pala e interesuar, për të cilat kërkohet sanksioni administrativ me gjobë. Ka ndonjë deklaram nga

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

anëtarët e KAS-it për qenien e tyre në konflikt interesi? Nuk ka. Janë njoftuar palët për zhvillimin e seancës?

Z. Y. Merkaç: Po, janë njoftuar.

Z. L. Braho: Meqenëse asnjëri nga palët nuk është i pranishëm, ia japim fjalën sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së që të na raportojë në lidhje me këtë kërkesë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Z. Y. Merkaç: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë administruar indicie për organizimin e 8 veprimtarive publike nga 5 institucione publike për të cilat pretendohet se janë kryer në kundërshtim me përcaktimet e neneve 91 e 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë këto denoncime dhe i ka shqyrtuar paraprakisht duke vlerësuar se informacioni dhe të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ. Ka nisur hetimin administrativ dhe me vendimin nr. 470, datë 9 maj 2023 ka marrë në shqyrtim denoncimet nr. 182, 183, 180, 172, 173, 219 të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara dhe denoncimet me nr. 226 dhe 227 të sinjalizuesit për shkelje administrative të zgjedhjeve të datës 14 maj 2023. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri ka vlerësuar se në Bashkia Çërrik ka raportuar në ndërfaqen e KQZ-së në datën 25 shkurt 2023 për zhvillimin e veprimtarive inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike Selvias të njësisë administrative Klos. Në këtë aktivitet ka marrë pjesë drejtuesi politik i qarkut Elbasan. Zhvillimi i këtij aktiviteti është publikuar në faqen *facebook* të kryetarit të Bashkisë Çërrik. Është denoncuar edhe një veprimtari tjetër, inspektimi në kantierin e zbatimit të

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

infrastrukturës publike në fshatin Shalës, ku edhe në këtë aktivitet ka marrë pjesë drejtuesi politik i qarkut të Elbasanit. Në përfundim të hetimit administrativ Komisioneri, duke vlerësuar se përdorimi i një aktiviteti i organizuar nga një institucion publik për të kryer thirrje elektorale në mbështetje të një force politike apo kandidati të caktuar përbën shkelje të detyrimeve të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe vënia në dispozicion e këtyre aktiviteteve nga kryetari i bashkisë nëpërmjet thirrjeve elektorale, ka vlerësuar se kryetari i Bashkisë Cërrik ka shkelur parashikimet e nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte i ka propozuar KAS-it marrjen e masës administrative në vlerën 10 mijë lekë ndaj kryetarit të Bashkisë Cërrik. Gjithashtu, edhe për kryetarin e Bashkisë Elbasan është denoncuar një veprimtari publike ku pretendohet se në datën 22 mars Bashkia Elbasan ka postuar në faqen *facebook*, njësia nr.5 ku ka nisur puna për rikonstrukcionin e rrugës “Theofan Papa” dhe slogani “S’ka kohë për pushim”. Një postim lidhur me këtë aktivitet është bërë edhe nga drejtuesi politik i qarkut Elbasan. Zhvillimi i këtij takimi është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga Bashkia Elbasan. Në njoftimin e bërë deklarohet paraprakisht nga Bashkia Elbasan pjesëmarrja e drejtuesit politik të qarkut të Elbasanit. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në përfundim të hetimit administrativ ka vlerësuar se përdorimi i aktivitetit i organizuar nga një institucion publik për të bërë thirrje elektorale në mbështetje të një force politike ose kandidati të caktuar përbën shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 91 të Kodit Zgjedhor. Kryetari i Bashkisë Elbasan Gledjan Llatja nëpërmjet vënies në dispozicion të këtyre aktiviteteve për kryerjen e thirrjeve elektorale ka shkelur parashikimet e nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Referuar nenit 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor Komisioneri i ka propozuar KAS-it marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 10 mijë lekë ndaj kryetarit të Bashkisë Elbasan. Gjithashtu, edhe për Bashkinë Kamëz janë regjistruar denoncimet me nr. 182 dhe nr. 183 për dy veprimtari publike në të cilat

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

pretendohet që në faqen zyrtare të Bashkisë Kamëz është postuar një video, një takim me strukturat e Partisë Socialiste në Kamëz. Postimi gjendet në linkun e shënuar në këtë denoncim dhe mban datën 4 mars 2023. Përmbajtja e postimit është “Me Linditën dhe Rakipin për t’u takuar me strukturat plot energji në Kamëz. Jam krenar për punën e jashtëzakonshme të Partisë Socialiste”. Në përfundim të hetimit administrativ Komisioneri, duke iu referuar edhe nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor, përcakton se nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve ose partive politike burime të organeve dhe enteve publike në nivel qendror dhe vendor. Vënia në dispozicion e faqes zyrtare në *facebook* për çdo mjet tjetër elektronik, medias sociale të institucioneve publike për publikimin ose ripostimin e veprimtarive me karakter politik elektorale në zgjedhje nga ana e këtyre institucioneve përbën përdorim të burimeve publike. Në këto kushte, Komisioneri, duke qenë se e ka gjetur në shkelje të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, i ka propozuar KAS-it marrjen e masës administrative në vlerën 10 mijë lekë ndaj kryetarit të Bashkisë Kamëz.

Z. L. Braho: Faleminderit, zoti Merkaj! Kisha një pyetje, meqenëse pjesë e hetimit kanë qenë edhe dy kryetarë të tjerë bashkish, konkretisht zoti Rexhë Biberi, kryetar i Bashkisë Tropojë, dhe zoti Adriatik Zotaj, kryetar i Bashkisë Poliçan. Me sa shoh nga hetimi, në rastin e kryetarit të Bashkisë Poliçan ose me saktë me denoncimin, rezulton se është pothuajse në të njëjtat kushte si kryetari i Bashkisë Cërrik, pra që ka një aktivitet me përfaqësues politik, ku janë bërë edhe thirrje propagandistike, por për këtë është pushuar hetimi. Ndërkohë është pushuar hetimi edhe për kryetarin e Bashkisë Tropojë. Mund të na sqaroni ju lutem në lidhje me këto dy çështje?

Znj. I. Osmanaj: Në lidhje me denoncimin ndaj kryetarit të Bashkisë Poliçan, objekti i denoncimit është si për rastin e Kamzës, por gjatë hetimit administrativ dhe

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

administrimit të provave, si dhe verifikimit të tyre, rezultoi që materiali, i cili është denoncuar për kryetarin e Bashkisë Poliçan nuk rezultonte në faqen *facebook* të Bashkisë Poliçan. Në këto kushte, duke qenë se ne nuk mundëm të administronim provë për aq sa pretendonte denoncuesi, pavarësisht se kishim një provë të administruar nga denoncuesi dhe për të bërë ballafaqimin e këtyre provave, i propozuam Komisionerit pushimin e hetimit administrativ ndaj kryetarit të Bashkisë Poliçan. Ndërsa për sa i përket denoncimit për Bashkinë Tropojë, është për një veprimtari për shpërdorim të burimeve publike. Gjatë hetimit administrativ ne nuk patëm një përgjigje nga kryetari i bashkisë ose nga personi përgjegjës për Bashkinë Tropojë dhe vijuar shqyrtimin dhe hetimin e rastit në bazë të provave që kishim në momentin e administrimit nga denoncuesi dhe rezultoi që këto prova nuk ishin të mjaftueshme për të vijuar më tej hetimin administrativ. Gjithashtu, duhej të plotësoheshin të gjitha kushtet, prokurimet duhet të ishin publike, të cilat ato ishin publike, dhe duhet të ishin edhe tre kushte të tjera kumulative që të konstatojmë shkelje. Duke qenë se ne nuk konstatuam shkelje, i propozuam Komisionerit pushimin e hetimit administrativ për këtë çështje. Ndërsa rastet e tjera janë ato që ju kemi propozuar në vendim. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit! Për rastin e Bashkisë Poliçan e kemi këtu raportimin e aktivitetit për të cilin është bërë denoncimi?

Znj. I. Osmanaj: Nëse është raportuar në ndërfaqe?

Z. L. Braho: Po.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

Znj. I. Osmanaj: Ne nuk e kemi shqyrtuar këtë gjatë hetimit administrativ. Ne kemi kërkuar vetëm në faqen e Bashkisë Poliçan nëse ekzistonte ky si material, i pretenduar edhe nga denoncuesi. Ndërsa për sa i përket raportimit në ndërfaqe apo jo, nuk i kemi hyrë këtij hetimi, sepse nuk ka qenë edhe objekt i hetimit administrativ.

Z. L. Braho: Mund ta kemi, mund ta gjejmë ne raportimin, se mund të ndryshojë situata nëse kemi raportimin, kemi edhe provat nga denoncuesi.

Znj. I. Osmanaj: Na lini pak kohë.

Z. L. Braho: Patjetër. Vetëm për rastin e Poliçanit. Ka ndonjë pyetje nga kolegët? Jo. Të sqaroj edhe diçka tjetër me zotin Merkaj. Vë re që rasti i Elbasanit dhe i Kamzës është i ngjashëm me rastet që kemi gjykuar edhe ditën e djeshme që ka të bëjë me përdorimin e faqeve zyrtare të *facebook*-ut të bashkive, përveç pjesës propagandistike. Po.

Znj. I. Osmanaj: Janë dy raste të ndryshme, në fakt. Për sa i përket Bashkisë Elbasan është për kryerje të thirrjeve elektorale nga deputeti zoti Damian Gjijknuri në një aktivitet të zhvilluar nga bashkia, ndërsa për sa i përket Bashkisë Kamëz është për një aktivitet të postuar në rrjetin social të faqes së bashkisë. Rasti i Bashkisë Kamëz është i ngjashëm me rastet që janë trajtuar dje dhe pardje nga trupa juaj.

Z. L. Braho: Pra, te rasti i Bashkisë Cërrik nuk ka postim në faqen zyrtare të *facebook* të bashkisë.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

Znj. I. Osmanaj: Jo.

Z. L. Braho: Janë shkelje vetëm thirrjet propagandistike në aktivitetet e organizuara nga bashkia.

Z. I. Rusmali: Te vendimi i Komisionerit lidhur me këto denoncime, janë dy pasazhe për dy denoncime të ndryshme. Njëri ka të bëjë me denoncimin nr. 183 ID Kamëz dhe diku në konkluzion ju thoni: “Vënia në dispozicion e faqeve zyrtare të *facebook*-ut apo çdo mjet tjetër elektronik, medie sociale, të institucioneve publike për publikimin dhe ripostimin e veprimtarive me karakter politik elektoral në zgjedhje nga ana e këtyre institucioneve përbën përdorim të burimeve publike”. Ndërsa diku më poshtë, te 226 ID thoni: “Kodi Zgjedhor... nuk parashikojnë asnjë rregullim ligjor të shprehur mbi administrimin e medias sociale nga ana e funksionarëve publikë”. Ka kontradiktë midis tyre? Apo aty i referoheni vetëm faqes së bashkisë?

Znj. I. Osmanaj: Sa i takon denoncimit të regjistruar me numër regjistri 227...

Z. I. Rusmali: Mund të jetë 227.

Znj. I. Osmanaj: Sa i përket denoncimit të regjistruar ndaj kryetarit të Bashkisë Kamëz, ne i referohemi... 183 ndjesë, postimeve që janë bërë në faqen e institucionit të Bashkisë Kamëz dhe për këtë kemi bërë këtë arsyetim. Për sa i përket denoncimit për Bashkinë Tropojë, është për postim në rrjetin social të kryetarit të bashkisë e për këtë nuk është se kemi një parashikim ose dispozitë ligjore referuese.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

Z. L. Braho: Edhe Bashkia Elbasan ka postim në faqen e *facebook*-ut të bashkisë, apo jo?

Znj. I. Osmanaj: Ka postim, por ka edhe thirrje elektorale.

Z. L. Braho: Bashkia Elbasan dhe Bashkia Kamëz kanë edhe postime në faqet e bashkive. Atëherë, zoti sekretar i Përgjithshëm, përfundimisht çfarë kërkoni nga KAS-i? Mbase ju vlen t'i referoheni edhe praktikës së KAS-it deri tani në lidhje me këto çështje, mbase ndryshoni qëndrim.

Z. Y. Merhaj: Ne vazhdojmë t'i qëndrojmë kërkesës sonë të mëparshme. Pranojmë kërkesën e Komisionerit, vendosjen e masave administrative për kryetarët e bashkive Elbasan, Kamëz dhe Cërrik në masën 10 mijë lekë.

Z. L. Braho: Faleminderit! Po presim edhe raportimin e Bashkisë Poliçan. Deklarojmë të mbyllur seancën për t'u tërhequr për vendim.

Rifillon

Ora 13.40

Z. L. Braho: Riçelim seancën e shqyrtimit administrativ të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 25, datë 10.05.2023. KAS-i, pasi u tërhoq për vendim, bazuar në kërkesën e Komisionerit dhe në provat bashkëlidhur kërkesës, me shumicë votash, vendosi:

- rrëzimin e kërkesës së Komisionerit nr. 25, datë 10.05.2023.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

- Ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

U shpall sot në datën 12 maj 2023.

Seancën e deklarojmë të mbyllur.

Vendimi nr. 102

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

12.05.2023
Ora 13.41

RENDI I DITËS

**Shqyrtimi i kërkesës nr. 24, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt
“Vendosje të sanksioneve administrative”**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, znj. I. Osmanaj, z. E. Mema.
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Rusmali: Çelim seancën për shqyrtimin në themel të kërkesës së Komisionerit nr. 24 për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zotit Florenc Doka, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Cërrik dhe zotit Astrit Seferkolli personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Devoll. Prezencë është trupa e KAS-it në përbërje të plotë, është administrata e KQZ-së me në krye sekretarin e Përgjithshëm, zotin Ylli Merkaj, dhe mungojnë palët, zoti Florenc Doka dhe zoti Astrit Seferkolli ose respektivisht përfaqësuesit e tyre, të cilët kanë marrë njoftim rregullisht, por kanë preferuar t'i rrinë larg kësaj seance. Ndonjë deklaram nuk ka, i bëmë edhe në seancën paraprake, kështu që mund të vazhdojmë me zotin Merkaj që të na tregojë kërkesën e Komisionerit.

**Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ**

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

Z. Y. Merkaç: Faleminderit! Në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë administruar indicie për organizimin e 7 veprimtarive publike nga 6 institucione publike për cilat pretendohet se nuk janë raportuar në ndërfaqen dedikuar për këtë qëllim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave link, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Komisioneri duke vlerësuar se informacioni i dhënë apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ, ka nisur hetimin administrativ dhe me vendimin nr. 469, datë 9 maj 2023 ka marrë në shqyrtim denoncimet e mësipërme. Gjatë hetimit administrativ është konstatuar që janë dy denoncime ndaj Bashkisë Cërrik për dy veprimtari publike për të cilat pretendohet se Bashkia Cërrik ka raportuar në ndërfaqen e raportimit të KQZ-së në datën 4 mars 2023, zhvillimi i një aktiviteti me tematikë inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike Daras, i planifikuar për t'u zhvilluar në datën 10 mars 2023. Nga faqja e *facebook*-ut e drejtuesit politik të qarkut Elbasan ky aktivitet është postuar në datën 6 mars 2023, ndërsa zhvillimi i aktivitetit është postuar në datën 10 mars në faqen *facebook* të Bashkisë Cërrik dhe në faqen *facebook* të kryetarit të Bashkisë Cërrik. Gjithashtu, edhe në denoncimin me nr. 175 ID pretendohet se Bashkia Cërrik ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të KQZ-së në datën 25 shkurt 2023 një aktivitet me temë “Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike”, i planifikuar për t'u zhvilluar në datën 6 mars 2023. Në faqen zyrtare *facebook* drejtuesi politik i qarkut të Elbasanit e ka postuar në datën 4 mars 2023, ndërsa në faqen *facebook* të Bashkisë Cërrik e të kryetarit të bashkisë ky aktivitet është postuar në datën 7 mars 2023. Pra, nga kontrolli që u bë në kanalet zyrtare të informimit të titullarit të institucionit përkatës nuk evidentohet asnjë postim tjetër online për zhvillimin e këtij aktiviteti. Pra, rezulton që aktivitetet janë kryer dhe datat e deklaruara për zhvillimin e tyre në faqen e raportimit në KQZ kanë qenë të plotësuara gabim. Referuar nenit 4, pika 3,

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, institucioni organizator ka detyrimin të raportojë në ndërfaqe 5 ditë përpara zhvillimit të të gjitha aktiviteteve që janë të hapura me pjesëmarrjen e publikut apo të medias dhe ato që kanë një axhendë informimi të publikut. Mosplotësimi i këtyre të dhënave në formën e kërkuar nga vendimi nr. 9 i vitit 2020 të Komisionit Rregullator do të çonte në një vlerësim jo të drejtë dhe një pamundësi për të monitoruar këto aktivitete. Veprimtaritë publike, objekt i denoncimeve të mësipërme, janë raportuar për t'u kryer në data të ndryshme nga ato që faktikisht janë kryer. Nëse gabimet e kryera nga ana e personit përgjegjës për raportim do të ishin gabime materiale, raportimi do të ishte në shkelje të afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 92 i Kodit Zgjedhor. Referuar nenit 10 të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, në rastet kur subjektet e parashikuara në pikën 4 të nenit 4 të këtij vendimi, nuk raportojnë apo raportojnë pjesërisht ose zhvillojnë veprimtari pavarësisht nga ndalimit të bërë nga Komisioneri, kur shkelja nuk përbën veprë penale, dënohet me gjobë nga 3 mijë deri në 9 mijë lekë. Në këto kushte, Komisioneri, duke vlerësuar se personi përgjegjës nuk ka raportuar saktësisht këto veprimtari, i ka propozuar KAS-it marrjen e masave administrative ndaj personit përgjegjës për mosraportim ose raportim të gabuar të Bashkisë Cërrik në masën 5 mijë lekë. Gjithashtu, kemi edhe denoncimin nr. 213 ID ndaj Bashkisë Devoll. Pretendohet se Bashkia Devoll në bashkëpunim me gjimnazin "Fuat Babani" Bilisht ka zhvilluar një aktivitet me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Poezisë. Personi përgjegjës për raportime të veprimtarive publike në institucionin e Bashkisë Devoll nuk i është përgjigjur kërkesës gjatë hetimit administrativ. Gjithashtu, është provuar gjatë hetimit administrativ se kjo veprimtari publike është postuar në faqen zyrtare *facebook* të Bashkisë Devoll. Duke qenë se provat e administruara janë vetëm foto, nuk provohet nëse ka thirrje elektorale gjatë këtij takimi. Konstatohet që takimi nuk ka qenë rastësor, por ka qenë i organizuar dhe i planifikuar për t'u zhvilluar. Në

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

përfundim të hetimit administrativ u provua se aktiviteti i mësipërm përbën veprimtari publike dhe mbart detyrimin për raportim në ndërfaqen e KQZ-së. Referuar pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, institucionet publike qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë ose ndërmarrjet shtetërore janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik. Bashkia Devoll ka pasur detyrimin për të raportuar në ndërfaqen e KQZ dhe nuk e ka bërë këtë raportim. Për sa më sipër, përgjegjës për raportimin është personi përgjegjës për drejtimin administrativ të institucionit publik, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore. Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i është drejtuar KAS-it për marrjen e masës administrative ndaj personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Devoll në masën 5 mijë lekë, zotit Astrit Seferkolli. Bashkëlidhur keni kërkesën dhe vendimin. Faleminderit!

Z. I. Rusmali: Faleminderit, zoti Merkaj! Ka pyetje nga kolegët? Nuk ka. Zoti Merkaj, ju i qëndroni kërkesës së paraqitur nga Komisioneri?

Z. Y. Merkaj: Po.

Z. I. Rusmali: Faleminderit! KAS-i do të tërhiqet për vendim dhe do ta shpallë vendimin për pak minuta.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

Rifillon

Ora 13.50

- Z. I. Rusmali:** Riçelim seancën. KAS-i, pasi shqyrtoi kërkesën dhe provat bashkëlidhur saj, bazuar në nenin 21, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendosi:
- pranimin me një ndryshim të kërkesës së Komisionerit.
 - Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zotit Florenc Doka, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Cërrik, gjobë në masën 7 mijë lekë;
 - vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zotit Astrit Seferkolli, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Devoll, gjobë në masën 5 mijë lekë.
 - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në fazën zyrtare të KQZ-së.
 - Bazuar në pikën 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.
 - Ky vendim shpallet sot në datën 12 maj 2023. Me kaq seanca mbyllet.

Vendimi nr. 103

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

12.05.2023
Ora 13.52

RENDI I DITËS

*Shqyrtimi i kërkesës nr. 26 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt
“Vendosje të sanksioneve administrative”*

PJESËMARRJA:

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, znj. I. Osmanaj, z. E. Mema
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. Elvis Çefa: Mirëdita të gjithëve! Fillojmë seancën për shqyrtimin në themel të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 26 të datës 10 maj 2023, me objekt: vendosje sanksioni administrativ ndaj zotit Arben Qafa, drejtor i qendrës kulturore “Margarita Tutulani” në Berat në vlerën 5 mijë lekë. Sipas shortit të hedhur në KQZ, relatori i kësaj çështjeje jam caktuar unë, anëtari Elvis Çefa. Me vendimin e djeshëm është vendosur kalimi në seancë dhe zhvillimi i kësaj seance. Verifikojmë fillimisht prezencën: është prezent KAS-i në përbërje të plotë; janë prezent sekretari i Përgjithshëm dhe administrata e KQZ-së; ka dijeni rregullisht, por nuk ka bërë kërkesë për t’u paraqitur apo për t’u përfaqësuar me avokat, personi i interesuar, zoti Arben Qafa. Në këto kushte nuk kemi pengesa për të vijuar me shqyrtimin e kërkesës

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

së Komisionerit, duke ia dhënë fjalën sekretarit të Përgjithshëm për një raportim të shkurtër të çështjes. Faleminderit! Zoti Merkaj, fjala për ju.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar një denoncim i regjistruar me numër regjistri 379 ID, në të cilin pretendohet se ka pasur përdorim të burimeve publike për qëllime zgjedhore. Denoncuesi përmes shkresës së administruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve pretendon se qendra kulturore “Margarita Tutulani”, në faqen e saj në rrjetin social *facebook*, shpërndan dhe kryen aktivitete propagandistike elektorale në favor të kryetarit aktual të Bashkisë së Beratit, zotit Ervin Demo. Është provuar gjatë hetimit administrativ se në faqen zyrtare të rrjetit social *facebook* të qendrës kulturore “Margarita Tutulani” në Berat është postuar fotografia e kandidatit për kryetar bashkie, zotit Ervin Demo për Bashkinë e Beratit për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Nga verifikimet paraprake dhe provat e administruara është vlerësuar se faqja e rrjetit social *facebook* me emrin qendra kulturore “Margarita Tutulani” është faqja zyrtare e institucionit në rrjetin social *facebook*. Referuar nenit 91, pika 1 të Kodit Zgjedhor, me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj, nuk mund të përdoret ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicionit në zgjedhje, burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor. Vënia në dispozicion e faqes zyrtare të *facebook*-ut apo çdo mjeti tjetër elektronik, media sociale të institucioneve publike për publikimin apo ripostimin e veprimtarive me karakter politik elektorale në zgjedhje, nga ana e këtyre institucioneve, përbën përdorim të burimeve publike. Në këto kushte Komisioneri ka vlerësuar se jemi përpara një shkeljeje administrative të Kodit Zgjedhor pasi vërehet qartazi promovimi i subjekteve zgjedhore në zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Në këto kushte Komisioneri ka vlerësuar se rasti objekt denoncimi i regjistruar përbën shkelje të

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe i ka kërkuar KAS-it propozimin për marrjen e masave administrative në vlerën 5 mijë lekë ndaj drejtorit të qendrës kulturore “Margarita Tutulani” në Berat. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit, zoti Merkaj! Ka pyetje nga kolegët?

Z. K. Bele: Qendra kulturore “Margarita Tutulani” është institucion në varësi të bashkisë, apo çfarë është?

Znj. I. Osmanaj: Është institucion në varësi të Bashkisë së Beratit. Ne kemi pasur komunikim edhe me personin përgjegjës për Bashkinë e Beratit dhe mbas komunikimit telefonik me të, na e ka konfirmuar që është në varësi të institucionit të Bashkisë, gjithashtu, administrohej dhe kontrollohej nga njëri prej punonjësve me pozicion jurist në qendrën kulturore.

Z. I. Rusmali: Një pyetje: kur ka ndodhur shkelja dhe kur e keni verifikuar ju?

Znj. I. Osmanaj: E verifikuar nga ana jonë ka qenë në fazën e shqyrtimit. Po ta shikoni edhe poshtë është data 03.05.2023, kur është bërë edhe *screenshot* i fotos që e mbante në faqen e saj zyrtare të institucionit të qendrës kulturore “Margarita Tutulani”. Ndërkohë, si denoncim na ka ardhur po në datën 03.05.2023 nga zoti Ivi Kaso i Partisë Demokratike.

Z. E. Çefa: Pyetje të tjera nuk ka. Përfundimisht, zoti Merkaj.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

Z. Y. Merkaç: Pranimi i kërkesës të vendosjes së gjobës në masën administrative në vlerën 5 mijë lekë për drejtorin e qendrës kulturore “Margarita Tutulani” në Berat. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! KAS-i do të tërhiqet për vendim dhe për pak minuta do të shpallim vendimin.

Rifillon

Ora 13:29

Z. E. Çefa: Riçelim seancën për shpalljen e vendimit lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr. 26, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. KAS-i, pasi e diskutoi çështjen në tërësi, vendosi:

- pranimin e pjesshëm të kërkesës së Komisionerit;
- marrjen e masës administrative gjobë në shumën dy mijë e pesëqind lekë ndaj zotit Arben Qafa, drejtor i qendrës “Margarita Tutulani” në Berat.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ –së.
- Kundër këtij vendimi personi i interesuar mund të bëjë ankim brenda afatit ligjor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë në Tiranë.

U shpall sot në datën 12 maj 2023.

Me kaq seancën e deklaroj të mbyllur.

Vendimi nr. 104

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.05.2023*

12.05.2023
Ora 14:00

RENDI I DITËS

*“Shqyrtimi i kërkesës nr. 27, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt
“Vendosje të sanksioneve administrative””.*

PJESËMARRJA:

- **KAS-i:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi i KQZ-së:** Z. Ylli Merkaaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. E. Lako: Atëherë çelim seancën në lidhje me çështjen e kërkesës nr. 27, të depozituar në datën 11.05.2023 nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për vendosje sanksioni administrativ ndaj kryetarit të Bashkisë së Elbasanit, zotit Gledian Llatja, në masën 10 mijë lekë dhe kryetarit të Bashkisë së Gramshit, zotit Arif Tafani, gjobë në masën 10 mijë lekë. Atëherë është për Bashkinë e Belshit. Relator jam zgjedhur unë, Elvin Lako. Palët e interesuara janë? Përsëri, jo. Shkurtimisht, meqenëse nuk ka patur kërkesa as për çështje paraprake për konflikt interesi, zoti sekretar i Përgjithshëm, dy fjalë në lidhje me kërkesën.

Z. Y. Merkaaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është regjistruar denoncimi me nr. ID 210 ndaj kryetarit të Bashkisë së Belshit, Arif Tafani. Në denoncim

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.05.2023**

pretendohet se kryetari i Bashkisë së Belshit ka postuar në faqen e vet në bashkëbisedim me fermerët për krijimin e grupit vendor të veprimit, që duke u bërë bashkë të krijohet mundësia për të marrë më shumë financime. Në këtë postim janë bashkuar edhe sloganet: “Të bashkuar jo të ndarë”, “Shqipëria e ardhmja jonë”, “S’ka kohë për pushim”. Në postim ka marrë pjesë edhe drejtuesi politik i qarkut të Elbasanit, ku gjatë fjalës së tij ka theksuar se në Belsh bashkë me Arifin dhe ekspertin e fushës Ermal Elezi zhvilluam një bashkëbisedim me fermerët pronarë të bujtinave dhe sipërmarrës në fushën e agroturizmit. Në datën 20.04.2023 Bashkisë së Belshit i është kërkuar informacion në lidhje me këtë denoncim, por nuk ka marrë përgjigje ndaj kërkesës së paraqitur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Në vijim të hetimit administrativ, kur është zhvilluar seanca dëgjimore në datën 03.05.2023 u ftuan të gjitha palët dhe nuk u paraqit asnjë përfaqësues i Bashkisë së Belshit. Në përfundim të shqyrtimit administrativ, nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve të denoncimit, rezultoi se gjatë fjalës së deputetit dhe drejtuesit të qarkut është vërejtur përdorimi i thirrjeve me natyrë tërësisht elektorale në një takim, si dhe thirrje për mbështetje duke u bërë aktiviteti jo më institucional, por elektoral. Përdorimi i aktivitetit të organizuar nga një organ publik për të kryer thirrje elektorale, duke i kërkuar mbështetje një subjekti zgjedhor në garë, përbën përdorim të burimeve publike në kuptim të nenit 91 të Kodit Zgjedhor për qëllime elektorale. Për sa më sipër, Kryetari i Bashkisë së Belshit ka lejuar përdorimin e aktivitetit institucional për kryerjen e thirrjeve elektorale, duke përdorur burime publike të organit që ai drejton dhe duke shkelur kështu detyrimin e parashikuar në nenin 91 të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte, Komisioneri duke gjetur si shkelje të nenit 91 të Kodit Zgjedhor nga ana e kryetarit të Bashkisë, i ka bërë propozim KAS-it për vendosje të masës administrative në

**Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA**

**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.05.2023**

vlerën dhjetë mijë lekë ndaj kryetarit të Bashkisë së Belshit, zotit Arif Tafani. Gjithashtu, në faqen zyrtare të KQZ-së është regjistruar denoncimi me nr. ID 239, 240, 241 dhe 242, ku pretendohet se në datën 23 mars 2023 Bashkia e Elbasanit ka zhvilluar një veprimtari publike, të cilën e ka njoftuar paraprakisht në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në datën 16 mars 2023. Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë edhe drejtuesi politik i Qarkut Elbasanit, deputetë të qarkut të Vlorës, sekretari dhe ministrja e Arsimit dhe e Sportit. Njoftimi për zhvillimin e kësaj veprimtarie publike është postuar në faqen zyrtare të kryetarit të Bashkisë së Elbasanit, ku është bashkë edhe slogani: “Elbasani s’ka kohë për pushim”, rrugët “Theofan Papa”, “Koço Brisku” dhe Ibrahim Merenja. Gjithashtu, foto të aktivitetit janë postuar në faqen zyrtare të drejtuesit politik me këtë përmbajtje: “Me Gledin dhe Elvisin në Elbasan ku u inspektuan nga afër punimet që po kryen për rehabilitimin e plotë të rrugës në lagjen “Haxhias” dhe lagjen “5 Maji””.

Gjithashtu, kemi edhe denoncimin nr. ID 240 për rehabilitimin edhe asfaltimin e rrugës “Coha” në fshatin Gjonme, njësi administrative Gjegjan. Kemi denoncimin 241 për zhvillimin e veprimtarive publike, për të cilën ka njoftuar paraprakisht në datën 16 mars 2023. Janë të gjitha të kryera nga Bashkia e Elbasanit, janë të gjitha denoncimet vetëm për kryetarin e Bashkisë së Elbasanit, janë bashkuar të gjitha bashkë dhe është bërë vetëm një propozim për shkelje të nenit 91 të Kodit. Duke qenë se Komisioneri ka konstatuar që është shkelur Kodi Zgjedhor, neni 91 i tij, i ka propozuar KAS-it marrjen e masës administrative për kryetarin e Bashkisë së Elbasanit në masën 10 mijë lekë. Faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit, zoti Merkaj! Pra, si përmbledhje propozohen këto masa për shkak se në aktivitetet e bashkisë kanë marrë pjesë persona politikë dhe aty ka

**Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA**

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.05.2023*

pasur thënie me karakter elektoral. Pak a shumë, kjo është ajo çfarë ju relatuat dhe çfarë është hetuar?

Z. Y. Merkaj: Po, po.

Z. E. Lako: Faleminderit! Ka ndonjë pyetje nga kolegët? Po, shkurtimisht ju kërkoni që KAS-i të pranojë kërkesën?

Z. Y. Merkaj: Kërkesën e Komisionerit për marrjen e masave administrative.

Z. E. Lako: Faleminderit! do të tërhiqemi për vendim dhe shumë shpejt do t'ju thërrasim.

Rifillon seanca

ora 14:10

Z. E. Lako: Atëherë, në lidhjen me kërkesën nr. 27 të Komisionerit, KAS-i me shumicë votash vendosi:

- Rrëzimin e kërkesës së Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zotit Llatja, kryetar i Bashkisë së Elbasanit dhe zotit Arif Tafani, kryetar i Bashkisë së Belshit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë në Tiranë brenda 45 ditëve nga shpallja e tij. Me kaq e deklaroj të mbyllur seancën.

Vendimi nr. 105

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

12.05.2023
Ora 14:12

RENDI I DITËS


Projektakti "Për pranimin për shqyrtim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 28".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:**
- **Të tjerë:**

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve, çelim seancën për vlerësimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes lidhur me kërkesën nr. 28 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të dt. 12.05.2023, me objekt "Vendosje sanksioni administrativ kundrejt drejtuesve të policive bashkiake", sipas lidhjes 1 të kësaj kërkesë, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë secilit. Sipas shortit të hedhur sot në KQZ, relatori i kërkesë jam caktuar unë, anëtari Elvis Çefa. Verifikojmë prezencën. Është prezent KAS-i në përbërje të plotë, është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe administrata e tij. Nuk ka prezencë të palëve të interesuara, megjithëse administrata konfirmon që kanë rregullisht dijeni për zhvillimin e kësaj seance. Kërkesa paraprake nga anëtarët për konflikt interesi të mundshëm nuk ka. Atëherë zoti Merkaj, shkurtimisht ju lutem, mendimin tuaj për elementët e formës dhe të përmbajtjes

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Po, pranë Komisionerit Qendror të Zgjedhjeve, është paraqitur kërkesa ankimore, kërkesa për vendosje sanksioni administrativ e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 28. Ku Komisioneri ka marrë në shqyrtim, me shkresë nr.4641/protokoll, ju është drejtuar të gjitha policive bashkiake të vendit, 61 policive bashkiake, për të hequr materialet propagandistike, të cilat nuk përmbajnë shënimin “prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...” dhe vijon emri i subjektit zgjedhor, duke iu lënë edhe një afat për të sjellë raportimin nëse këto postera e përmbajnë apo jo këtë shënim. Në përfundim të afatit të përcaktuar nga Komisioneri, 57 polici bashkiake nuk e kanë kthyer raportimin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve sipas urdhërimeve të Komisionerit. Në këto kushte, Komisioneri ka propozuar masën administrative në vlerën 5000 (pesë mijë) lekë, për 57 drejtues të policive bashkiake që është bashkëlidhur dhe vendimi nr. 424. Nga verifikimi paraprak konstatohet, se kërkesa plotëson elementet formalë të nenit 130 të Kodit Zgjedhor, dhe në këto kushte i propozojmë KAS-it kalimin e kërkesës për shqyrtim administrativ. Faleminderit

Z. Elvis Çefa: Ju faleminderit zoti Merkaj. Pyetje nga kolegët nuk ka. Atëherë KAS-i i konsultuar në vend, vendosi: kalimin për shqyrtim administrativ të kërkesës nr. 28, të datës 12.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosje sanksioni administrativ. Seanca e themelit për zhvillimin e kësaj kërkesë do të caktohet ditën e Hënë në dt. 15.05.2023, ora 12:30. Me kaq seanca deklarohet e mbyllur, Faleminderit!

Vendimi nr. 106

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

12.05.2023
Ora 14:12

RENDI I DITËS

Projektakti "Për pranimin për shqyrtim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 28".


PJESËMARRJA:

- **KAS-i:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi i KQZ-së:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve, çelim seancën për vlerësimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes lidhur me kërkesën nr. 28 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të dt. 12.05.2023, me objekt "Vendosje sanksioni administrativ kundrejt drejtuesve të policive bashkiake", sipas lidhjes 1 të kësaj kërkesë, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë secilit. Sipas shortit të hedhur sot në KQZ, relatori i kërkesë jam caktuar unë, anëtari Elvis Çefa. Verifikojmë prezencën. Është prezent KAS-i në përbërje të plotë, është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe administrata e tij. Nuk ka prezencë të palëve të interesuara, megjithëse administrata konfirmon që kanë rregullisht dijeni për zhvillimin e kësaj seance. Kërkesa paraprahe nga anëtarët për konflikt interesi të mundshëm nuk ka. Atëherë zoti Merkaj, shkurtimisht ju lutem, mendimin tuaj për elementët e formës dhe të përmbajtjes

Z. Y. Merkaj: Po, pranë Komisionerit Qendror të Zgjedhjeve, është paraqitur kërkesa ankimore, kërkesa për vendosje sanksioni administrativ e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 28. Ku Komisioneri ka marrë në shqyrtim, me shkresë

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

nr.4641/protokoll, ju është drejtuar të gjitha policive bashkiake të vendit, 61 policive bashkiake, për të hequr materialet propagandistike, të cilat nuk përmbajnë shënimin “prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...” dhe vijon emri i subjektit zgjedhor, duke iu lënë edhe një afat për të sjellë raportimin nëse këto postera e përmbajnë apo jo këtë shënim. Në përfundim të afatit të përcaktuar nga Komisioneri, 57 polici bashkiake nuk e kanë kthyer raportimin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve sipas urdhërimeve të Komisionerit. Në këto kushte, Komisioneri ka propozuar masën administrative në vlerën 5000 (pesë mijë) lekë, për 57 drejtues të policive bashkiake që është bashkëlidhur dhe vendimi nr. 424. Nga verifikimi paraprak konstatohet, se kërkesa plotëson elementet formalë të nenit 130 të Kodit Zgjedhor, dhe në këto kushte i propozojmë KAS-it kalimin e kërkesës për shqyrtim administrativ. Faleminderit

Z. Elvis Çefa: Ju faleminderit zoti Merkaj. Pyetje nga kolegët nuk ka. Atëherë KAS-i i konsultuar në vend, vendosi: kalimin për shqyrtim administrativ të kërkesës nr. 28, të datës 12.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosje sanksioni administrativ. Seanca e themelit për zhvillimin e kësaj kërkesë do të caktohet ditën e Hënë në dt. 15.05.2023, ora 12:30. Me kaq seanca deklarohet e mbyllur, Faleminderit!

Vendimi nr. 106

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

**12.05.2023
Ora 14:16**

RENDI I DITËS

Projektakti "Për pranimin për shqyrtim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 29".

PJESËMARRJA:

- **KAS-i:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali, Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi i KQZ-së:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Rusmali: Mirë, çelim seancën për shqyrtimin paraprak të kërkesës së Komisionerit nr. 29, për vendosjen e sanksionit administrativ kryetareve të bashkive, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur kërkesës. (nuk po i lexoj emrat) Janë njoftuar?

Z. Y. Merkaj: Po janë njoftuar.

Z. I. Rusmali: Janë njoftuar. Atëherë seanca është e rregullt, mund të vazhdojmë shqyrtimin, KAS-i është në përbërje të plotë, administrata e Komisionit Zgjedhor të Zgjedhjeve është këtu, për të përfaqësuar Komisionerin në parashtrimin e kërkesës. Zoti Merkaj, jemi në seancë paraprake.

Z.Y. Merkaj: Faleminderit! Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa nr. 29 e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosje sanksioni administrativ të 13 kryetarëve të bashkive, pasi nuk kanë respektuar afatin e përcaktuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, për dhënien e informacioni për

**Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

afishimin dhe përcaktimin e vendeve publike në territorin e bashkive përkatëse, për afishim prej partive politike e subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike. Duke qenë se këta kryetarë bashkie brenda 30-35 ditëve para datës së zgjedhjeve nuk i kanë vendosur këto vendet e afishimit edhe pas thirrjes së Komisionerit nuk i kanë vendosur, atëherë Komisioneri ka propozuar marrjen e masave administrative për 13 kryetarë bashkie, që nuk e kanë respektuar këtë detyrim ligjor. Duke parë kërkesën e Komisionerit konstatohet se i plotëson të tre elementët formalë të parashikuar në nenin 130 i Kodit Zgjedhor dhe i kërkohet KAS-it të kalojë për shqyrtim administrativ.

Z. I. Rusmali: Në rregull, kolegë pyetje? Nuk ka pyetje. Mirë, dakord. Atëherë KAS-i i konsultuar në vend, merr vendimin që të pranojë për shqyrtim kërkesën nr. 29, dhe të caktojë seancën e shqyrtimit ditën e Hënë, në orën 13:00. Këtu mbyllim këtë seancë paraprake.

Vendimi nr. 107

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

12.05.2023
Ora 14:19

RENDI I DITËS

Projektakti "Për pranimin për shqyrtim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 30".

PJESËMARRJA:

- **KAS-i:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali, Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi i KQZ-së:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. E. Lako: Atëherë çelim seancën paraprake për kërkesën nr. 30 të Komisionerit, për, marrje masash administrative ndaj disa personave përgjegjës në disa ministri. Shkurtimisht zoti Merkaj, dy fjalë në lidhje me plotësimin e elementeve të formës dhe përmbajtjes për këtë kërkesë. Ju mendoni që i plotëson?

Z. Y. Merkaj: Po kërkesa nr. 30 i plotëson 3 elementët e parashikuar në nenin 130 të Kodit Zgjedhor, dhe kërkohet të kalohet në seancë për shqyrtim. Faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit! Ndonjë pyetje? Atëherë, KAS-i i konsultuar në vend, vendosi kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim në dt.15.05.2023, ditën e Hënë, në orën 13:30. Me kaq e deklaroj seancën të mbyllur, faleminderit!

Vendimi nr. 108

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

12.05.2023
Ora 14:20

RENDI I DITËS

Projektakti "Për pranimin për shqyrtim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 31".

PJESËMARRJA:

- **KAS-i:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali, Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi i KQZ-së:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. K. Bele: Çelim seancën për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 31, KAS me kuorum të plotë, , është një denoncim i KRIIK i datës 22 Maj 2023, lidhur me gjetjet e rekomandimet për javën Prill 21-27, për të cilën Komisioneri ka vendosur t'i propozojë Komisionit të Ankimeve e Sanksioneve masën administrative në vlerën 3 000 (tre mijë) lekë, për Rakip Sulin , Kryetarin e Bashkisë Kamëz dhe Blerim Shera Kryetar i Bashkisë Vorë. Zoti Sekretar i Përgjithshëm me këtë rast çfarë keni për të shtuar?

Z. Y. Merkaj: Komisioneri ka paraqitur kërkesën nr. 31, për vendosje sanksioni administrativ. Nga verifikimi paraprak i kërkesës konstatohet se i plotëson të tre elementët e parashikuar në nenin 130 të Kodit Zgjedhor: kompetencën, legjitimitimin, dhe afatin e paraqitur për shqyrtim. Kërkojmë që kërkesa të kalojë për shqyrtim në seancë, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.05.2023*

Z. K. Bele: Në rregull, pyetje në këtë fazë nuk kemi. KAS i konsultuar në vend, vendos kalimin e kësaj kërkesë për shqyrtim themeli, dhe cakton si datë, ditën e Hënë, datën 15.05.2023, orën 14:00. Me kaq seanca mbyllet. Faleminderit.

Vendimi nr. 109

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*

